




1/41-4

Statuti

Shtator/2025

STATUTI I BPrAL KOLEGJI UBT


PRISHTINË, Shtator 2025



Në pajtim me Ligjin për Arsim të Lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037 dhe në bazë të kërkesave të Agjensionit të Akreditimit të Kosovës për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Universiteti për Biznes dhe Teknologji, i njohur nga MASHT, me CERTIFIKATËN për Licencim Nr. 817/02 datë 19.10.2004, në bazë të Vendimit mbi Themelimin Nr. 808/02 – 1, datë 18.10.2004 nxjerrë nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi nga Prishtina, Shtator 2025, Bordi i BPrAL Kolegji UBT, nxjerr këtë:

STATUT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Themeluesi i lartshënuar themelon dhe me këtë Statut i përcakton dhe i rregullon çështjet themelore statusore e organizative, statusin e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve dhe punonjësve të tjerë, financimin e punës, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për funksionalizimin dhe organizimin e punës si BPrAL KOLEGJI UBT me seli në Prishtinë, dhe njësit akademike sipas Akreditimit dhe Licencimit (në tekstin e mëtejshëm: BPrAL KOLEGJI UBT), e sidomos :

- llojin e BPrAL Kolegji BPrAL dhe kohëzgjatjen për të cilën është themeluar;
- emrin dhe selinë e BPrAL Kolegji UBT;
- qëllimet dhe veprimtarinë e BPrAL Kolegji UBT;
- themeluesit e BPrAL Kolegji UBT;
- paraqitjen në qarkullim juridik dhe përgjegjësinë për obligimet e BPrAL Kolegji UBT;
- përfaqësimin dhe prezantimin e BPrAL Kolegji UBT;
- qeverisjen dhe mënyrën e marrjes së vendimeve lidhur me qeverisjen e tij;
- organizimin e BPrAL Kolegji UBT;
- informimin në BPrAL Kolegji UBT;
- pushimin e BPrAL Kolegji UBT;
- aktet e përgjithshme në BPrAL Kolegji UBT;
- procedurën për ndryshim dhe plotësim të Statutit të BPrAL Kolegji UBT, si dhe
- çështjet tjera lidhur me themelimin, punën dhe funksionalizimin e BPrAL Kolegji UBT.

2.4.

Neni 2.

Statuti është hartuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi. Ai e shtrin veprimtarin e vet mbi të gjitha njësitë përbërëse organizative të BPrAL Kolegji UBT.

Neni 3

Misioni i BPrAL Kolegji UBT është:

- a) Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si dhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtar të rinj;
- b) Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;
- c) Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- d) Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë;
- e) Realizon kërkimin shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësive përbërëse organizative, kryesore, bazë dhe ndihmës;
- f) Ofron shërbimin për të tretët, në përputhje me misionin dhe me statusin juridik të tij.

Neni 4

Arsimi i lartë në BPrAL Kolegji UBT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.

Neni 5

Liria akademike në BPrAL Kolegji UBT qëndron në respektimin e shumëllojshmërisë të opsioneve, të ideve e metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor si dhe të shërbimeve në përputhje me standardet evropiane.

Neni 6

BPrAL Kolegji UBT si institucion autonom, i njihet e drejta e:

- a) Vetëqeverisjes për të organizuar strukturat e brendshme dhe veprimtaritë e ndryshme nëpërmjet këtij statuti dhe rregulloreve, të hartuara në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) Hartimit dhe zhvillimit të pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;
- c) Përcaktimit të kriterëve të veçanta të pranimit të studentëve në programin e studimeve;
- d) Mbledhjes së fondeve dhe përfitimit të mjeteve materiale, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) Realizimit të marrëveshjeve të pavarura me subjekt të ndryshëm ose qeveri për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore;
- f) Realizimit të marrëveshjeve me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera, vendase ose të huaja, publike ose private;
- g) Administrim të fondeve dhe të ardhurave të tjera, që disponon sipas mënyrës së përshkruar me ligj;
- h) Aktivitetit botues në përputhje me nevojat e procesit mësimor e të kërkimit shkencor;
- i) Përzgjedhjes së personalitetit të tij.

Neni 7

BPrAL Kolegji UBT do të regjistrohet në regjistër përkatës tek autoriteti i MASHT-it, në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi për aplikim në Kosovë.

94.

II. LLOJI DHE KOHËZGJATJA E BPRAL KOLEGJI UBT

Neni 8.

1. BPrAL Kolegji UBT themelohet në formë të institucionit autonom privat (jopublik) në Kosovë dhe autonom nga ndikimet politike, ndërhyrjet e jashtme apo faktorëve të tjerë, që mund të dëmtojnë cilësinë e studimeve dhe autonominë e tij.
2. BPrAL Kolegji UBT është themeluar për kohë të pacaktuar, dhe i njëjti e ka cilësinë e personit juridik.

Neni 9.

Bordi i BPrAL Kolegji UBT, me akt të veçantë, do të caktojë datën e përvjetorit të themelimit të tij dhe mënyrën e organizimit.

III. EMËRTIMI, SELIA DHE VULAT E BPRAL KOLEGJI UBT

Neni 10.

1. BPrAL Kolegji UBT dhe në qarkullimin juridik paraqitet nën emrin e shkruar në gjuhën shqipe:
 - BPrAL Kolegji UBT ose me shkurtesën UBT.
2. Emri i Institucionit në gjuhën angleze është:
 - PBHE UBT College ose me shkurtesën UBT.

Neni 11.

Në qarkullimin juridik me persona të tretë, varësisht nga natyra e marrëdhënies juridike apo të komunikimit, BPrAL Kolegji UBT paraqitet nën emrin e plotë shkruar në gjuhën shqipe apo në gjuhën angleze dhe/apo në të dyja gjuhët.

Neni 12.

1. Emri dhe shkurtesa e BPrAL Kolegji UBT mund të ndryshohet.
2. Vendimin mbi ndryshimin e emrit apo shkurtesës së BPrAL Kolegji UBT e merr Bordi.
3. Me ndryshimin e BPrAL Kolegji UBT dhe shkurtesës së emrit të tij, nuk mund të vihen në lajthim apo të lëndohen interesat e personave të tretë.

Neni 13.

BPrAL Kolegji UBT ka këto shenja identifikuese:

- *stemën, vulën, vulën e thatë, flamurin dhe gjerdanin e Rektorit.*

Neni 14.

1. E drejta në shfrytëzimin e emrit të Institucionit apo shkurtesës së emrit dhe shenjave identifikuese të Institucionit nuk mund të bartet në persona të tjerë.
2. Bartja e së drejtës në shfrytëzimin e Institucionit si subjekt juridik, shkurtesës së emrit dhe shenjave identifikuese mund të bëhet, nëse në pajtim me ligj dhe me këtë Statut, bartet e drejta në qeverisje me Institucion në person tjetër.

9.8

Neni 15.

1. Selia e BPrAL Kolegji UBT është në Prishtinë, Lagja "Kalabria", e cila ushtron veprimtarin e vet në Objektivin në Rr. Bill Clinton, Prishtinë, si dhe Rr. Ibrahim Rugova, Zona Ekonomike Konjuh Lipjan, si dhe në njësit të tjera të përcaktuara me vendim të veçantë.
2. BPrAL Kolegji UBT mund të ndryshojë selinë e vet.
3. Vendimin mbi ndryshimin e selisë e merr Bordi i Kolegjit të UBT-së.

Neni 16.

1. BPrAL Kolegji UBT e ka vulën kryesore dhe vulën datare.
2. Vula kryesore është e rrumbullakët dhe shërben për të dëshmuar vërtetësinë e nënshkrimit të personit të autorizuar për përfaqësim apo prezantim të BPrAL Kolegji UBT.
3. Vula datare është drejtkëndëshe dhe shërben për të dëshmuar vërtetësinë e pranimit apo dorëzimit të akteve apo shkresave dhe shënimit të numrit dhe datës të aktit apo pranimit ose dorëzimit të aktit apo shkresës.

Neni 17.

Teksti në vulën kryesore dhe vulën datare shkruhet në gjuhën shqipe, apo në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, me përmbajtje të njëjtë.

Neni 18.

1. Me vendim të Bordit caktohet dukja dhe përbërja e vulës kryesore dhe vulës datare.
2. Për përdorimin e vulave përgjegjës i drejtpërdrejtë është Presidenti i BPrAL Kolegji UBT apo personat e autorizuar nga Presidenti i sajë.

IV. FUSHËVEPRIMTARIA DHE QËLLIMI

Neni 19.

1. Veprimtaria e BPrAL Kolegji UBT është e përqendruar në zhvillimin e procesit mësimor akademik dhe kërkimeve shkencore cilësore, paraparë sipas standardeve ndërkombëtare.
2. Me veprimtarin e vet BPrAL Kolegji UBT synon që të arrijë këto agjenda dhe qëllime:
 - a) Themelimin e një institucioni akademik me tipare dhe karakter ndërkombëtar jopublik, si një alternativë e rëndësishme në ofrimin e studimeve cilësore, kërkimit shkencor në kuadër të institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe më gjerë;
 - b) Të krijojë mundësinë më të mirë për studime cilësore ndërkombëtare në gjuhën angleze, shqipe, etj. në të gjitha nivelet e arsimit si dhe mësimi gjatë gjithë jetës;
 - c) Të sjellë dhe të promovojë cilësitë botërore në studimet, hulumtimet dhe inovacion;
 - d) Të zhvillojë dhe të promovojë kapacitetet profesionale dhe akademike vendore në përputhje me kërkesat më të larta të studimeve akademike në botë;
 - e) Të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë, si dhe në krijimin e një mjedisi dhe kulture akademike në shoqërinë kosovare, në rajon dhe më gjerë;
 - f) Të ndërtojë një institucion të hapur për studime për të gjithë, pa dallim dhe mbi bazën e meritës, dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm profesionalë për bashkëpunim të suksesshëm me të gjitha institucionet relevante kombëtare dhe ndërkombëtare qoftë në Kosovë apo jashtë Kosovës;

9.4.

- g) *Të shërbejë si qendër referuese për studime akademike ndërkombëtare në rajon, ku do të artikuloreshin dhe promovoheshin vlerat universale të studimeve dhe kërkimeve, si ato gjuhësore dhe kulturore.*

Neni 20.

1. BPrAL Kolegji UBT, në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, i gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e institucionit akademik autonom jopublik, të pandikuar politikisht dhe ekonomikisht.
2. Në bazë të kësaj BPrAL Kolegji UBT ka këto të drejta administrative, pedagogjike dhe akademike:
 - a) *Të zgjedhë organet qeverisëse dhe profesionale dhe të përcaktojë, me akte të veçanta, organizimin e brendshëm dhe mandatin e tyre;*
 - b) *Të hartojë politikat dhe planet zhvillimore, si dhe komunikimin e lirë me publikun;*
 - c) *Të planifikojë dhe të përcaktojë kushtet e regjistrimit, metodat e mësimdhënies dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve për sigurimin e cilësisë;*
 - d) *Të vendosë për përmbajtjet dhe strukturën e programeve akademike të tij;*
 - e) *Të japë tituj shkencorë dhe grada nderi për personelin akademik.*
3. BPrAL Kolegji UBT është institucion me të gjitha të drejtat dhe liritë e një personi të vetëm juridik që ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë në fuqi, duke përfshirë:
 - a) *Të drejtën për të paditur dhe për të qenë i paditur;*
 - b) *Të drejtën për ndalimin apo kufizimin e përdorimit të shenjave identifikuese dhe emrin e BPrAL Kolegji UBT, pa autorizimin me shkrim nga Presidenti apo Bordi;*
 - c) *Të drejtën për menaxhim, administrim, përfaqësim dhe zotërim të tërë pasurisë së luajtshme dhe atë të paluajtshme të BPrAL Kolegji UBT, duke përfshirë këtu edhe pronësinë intelektuale të kërkuar apo fituar në emër të tij;*
 - d) *Të drejtën e miratimit të të gjitha shenjave identifikuese të BPrAL Kolegji UBT përshkruar në nenin 13 të këtij Statuti;*
 - e) *Të drejtën e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok, me bartësit apo institucionet akademike e organizatat e ndryshme në vend dhe jashtë vendit.*

Neni 21.

1. Personeli akademik, administrativ dhe studentët gëzojnë të drejta të patjetërsueshme në përputhje me këtë Statut dhe aktet tjera normative juridike e akademike të BPrAL Kolegji UBT.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të tyre përfshijnë:
 - a) *Të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës, mjeteve mësimore e shkencore, shërbimet informative dhe administrative, si dhe infrastrukturën e objektit të BPrAL Kolegji UBT brenda orarit të punës dhe orarit mësimor;*
 - b) *Të drejtën e kërkesës për ofrimin e shërbimeve cilësore administrative, profesionale dhe akademike, por jo kërkesa të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti;*
 - c) *Lirinë e shprehjes së fjalës në përputhje me rendin shtëpiak dhe kodin e mirësjelljes së BPrAL Kolegji UBT, si dhe rregullativën tjetër juridike në fuqi;*
 - d) *Të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi apo format tjera të lëndimit fizik apo emocional mbi baza racore, gjinore, etnike, fetare, sociale, kulturore, politike, shtetërore dhe të origjinës.*

24

V. THEMELUESIT E INSTITUCIONIT

Neni 22.

Themelues i BPrAL Kolegji UBT është: Dr. Edmond HAJRIZI nga Prishtina, Lagja "Bill Clinton", H7 4/4, dhe i cili posedon me ID-në numër 1030397076, i cili njëkohësisht është edhe Kryetar (President) i Bordit të Institucionit.

Neni 23.

Cilësinë e bashkëthemeluesit respektivisht bashkë aksionarit të BPrAL Kolegji UBT mund të fitojë edhe personi tjetër (personi i tretë) në bazë të shitjes, bartjes së aksioneve në të, trashëgimisë, blerjes së aksioneve shtesë sipas vendimit mbi rritjen e kapitalit themelor të BPrAL Kolegji UBT, apo sipas bazës tjetër të përcaktuar me ligj ose me këtë Statut.

Neni 24.

Themeluesi i Institucionit gjegjësisht aksionarët e tij kanë këto të drejta:

- a) Të drejtën në dividend sipas ligjit dhe këtij Statuti;
- b) Të drejtën në shpërndarjen falas të aksioneve, nëse fitimi i realizuar nuk shpërndahet në dividendë por për shumën e fitimit rritet kapitali themelor i BPrAL Kolegji UBT e nuk rritet vlera nominale e aksioneve ekzistuese;
- c) Të drejtën e lënies peng të aksioneve me gëzimin e të drejtës në votë apo pa të, varësisht nga marrëveshja e pengut;
- ç) Të drejtën në shpërndarjen proporcionale të neto pasurisë së BPrAL Kolegji UBT në rast të likuidimit dhe falimentimit;
- d) Të drejtën në një votë për çdo aksion të cilën e ka në pronësi;
- e) Të drejtën në shitjen apo në transferim në mënyrë tjetër të aksioneve;
- f) Të drejtën në lënien në trashëgim të aksioneve;
- g) Të drejtën e pjesëmarrjes në qeverisje me BPrAL Kolegji UBT sipas ligjit dhe këtij Statuti;
- h) Të drejtën në informim në lidhje me veprimtarinë e BPrAL Kolegji UBT në pajtim me ligjin dhe këtë Statut, si dhe
- i) Të drejtat tjera të përcaktuara me ligj apo me këtë Statut.

VI. STRUKTURA ORGANIZATIVE - organet udhëheqëse

Qeverisja e Institucionit

Neni 25.

1. Në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, organet udhëheqëse të BPrAL Kolegji UBT do të jenë:
 - Bordi;
 - Këshilli Akademik;
 - Këshilli Drejtues;
 - Rektorati.
2. Të gjitha postet e organeve udhëheqëse respektivisht qeverisëse të BPrAL Kolegji UBT zgjidhen me mandat të caktuar kohor.
3. Zgjedhja e anëtarëve në organet qeverisëse të BPrAL Kolegji UBT bëhet së paku një (3) muaj para fillimit të vitit akademik, por në raste të caktuara edhe gjatë vitit akademik.

g.h.

Këshilli Akademik

Neni 26

1. Këshilli Akademik është organi më i lartë akademik i BPrAL Kolegji UBT.
2. Anëtarët të cilët përbejnë Këshillin Akademik janë:
 - a) *Rektori;*
 - b) *Zëvendës Rektori (-ët);*
 - c) *Drejtoret dhe Dekanët e njësive tjera akademike;*
 - d) *Nga një (1) anëtar nga radhët e mësimdhënësve të çdo fakulteti, i zgjedhur nga vet stafi akademik;*
 - e) *Nga një (1) anëtar nga radhët e studentëve të çdo fakulteti, të zgjedhur nga vetë studentët;*
 - f) *Sekretari i BPrAL Kolegji UBT, i cili është anëtar i përhershëm i Këshillit Akademik, pa të drejtë vote.*
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Akademik është katër (4) vjet, me përjashtim të përfaqësuesve të studentëve, mandati i të cilëve është një (1) vit akademik.
4. Punën e Këshillit Akademik e kryeson Rektori si Kryetar i Këshillit Akademik apo Zëvendës Rektori. Në rastet kur mungon Rektori, Këshillin Akademik e kryeson Zëvendës Rektori, kurse në rastet kur edhe ai mungon, atëherë mbledhjen e Këshillit Akademik e kryeson një anëtar i zgjedhur nga vetë Këshilli Akademik.
5. Këshilli Akademik nxjerr Rregulloren e punës dhe Rregulloren për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të tij.
6. Këshilli Akademik, përmes Rektorit, i jep udhëzime Bordit të BPrAL Kolegji UBT lidhur me zhvillimin e veprimtarive akademike dhe burimet e nevojshme për mbështetjen e tyre.

Përgjegjësitë e Këshillit Akademik

Neni 27.

Përgjegjësit kryesore të Këshillit Akademik janë:

- a) *Zbatimi i procedurave për sigurimin e standardeve akademike si dhe rishikimin dhe vlerësimin e përmbajtjeve programore;*
- b) *Diskutimi i çështjeve të përgjithshme në lidhje me planet zhvillimore strategjike që lidhen me pjesën akademike, punën kërkimore shkencore, regjistrimin e studentëve (numrin dhe kriteret) dhe lëndët mësimore në Institucion;*
- c) *Shqyrtimi dhe miratimi i planprogrameve në bazë të rekomandimeve të Këshillave të fakulteteve;*
- d) *Shqyrtimi dhe miratimi i gjuhës në të cilin zhvillohen studimet në bazë të rekomandimeve të Këshillave të fakulteteve;*
- e) *Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të vlerësimit për sigurimin e cilësisë në studime;*
- f) *Përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të shkallës së arritshmërisë së studentëve, të bazuara në rekomandimet e Këshillave të fakulteteve;*
- g) *Miratimi i procedurave për dhënien e gradave shkencore dhe atyre akademike, titujve të nderit, diplomave dhe certifikatave, si dhe titujve të nderit.*
- h) *Miratimi i procedurave për të definuar statusin e studentit.*

Komisionet Këshilluese

Neni 28.

Këshillit Akademik mund të ngritë komisione këshilluese për sigurimin e cilësisë në fushëveprimin e tij nga neni

2.4

22 i këtij Statuti, si dhe mund të delegojë detyra dhe përgjegjësi të kufizuara nga fushëveprimi i tij.

Rektorati

Neni 29.

1. Rektorati përfaqëson strukturën akademike të Institucionit.
2. Rektorati për punën e tij i përgjigjet Bordit të BPrAL Kolegji UBT dhe për çështje akademike i përgjigjet Këshillit Akademik.
3. Rektorati përbëhet nga:
 - a) Rektor;
 - b) Zëvendës Rektor;
 - c) Dekanët,
 - d) Drejtoret e Departamenteve, si dhe
 - e) Sekretari.
4. Rektori ka autorizimin e plotë në zbatimin e detyrave përcaktuar me alinenë 1 të këtij neni. Në përputhje me këtë, Rektori është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe vendimeve akademike të miratuara nga Këshilli Akademik.

Rektori

Neni 30.

1. Rektori është udhëheqësi më i lartë akademik i BPrAL Kolegji UBT, i cili udhëheq me Këshillin Akademik dhe përfaqëson Rektoratin e BPrAL Kolegji UBT dhe jashtë tij. Rektori merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit dhe komisioneve të tij.
2. Rektori dhe Zëvendës Rektori emërohen nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT. Kandidatët për këto dy poste duhet të kenë gradë shkencore të doktorit të shkencave dhe gradën akademike të profesorit apo ekuivalente me të, duke dëshmuar edhe aftësi menaxhuese. Mandati i emërimeve zgjat katër (4) vjet, me mundësi edhe të një rizgjedhje. Procedura e zgjedhjes është si në vijim:
 - a) Vendimin për zgjedhjen e Rektorit e bën Bordi i BPrAL Kolegji UBT.
 - b) Një komision i përbashkët nga Këshilli Akademik (3) dhe Këshilli Drejtues (2) bën vlerësimin e dokumentacionit për kandidatët që kanë aplikuar.
 - c) Komisioni sipas pikës së mësipërme, listën me kandidatet që përmbushin kushtet për Rektori ia prezanton Bordit të UBT-së.
 - d) Kandidatët i paraqesin vizionet dhe programin e zhvillimit të Institucionit para Bordit;
 - e) Bordi i BPrAL Kolegji BPRAL UBT e bën zgjedhjen dhe emërimin e Rektorit dhe Zëvendës Rektorit (ët).
3. Udhëheqësi i Bordit të BPrAL Kolegji UBT mund ta caktojë një ushtrues detyre në rolin e Rektorit ose Zëvendës rektorit, në rastin kur Rektori ose Zëvendës Rektori, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund ta ushtrojnë funksionin e tyre.
4. Përgjegjësitë kryesore të Rektorit, janë:
 - a) Zbatimi i ligjit dhe akteve të tjera normative juridike e akademike të BPrAL Kolegji UBT;
 - b) Përfaqësimi me dinjitet dhe autoritet i BPrAL Kolegji UBT në të gjitha institucionet relevante akademike dhe shkencore, brenda domenit të vet të përgjegjësisë;
 - c) Të nënshkruaj rregulloret e punës së personelit akademik në Këshillin Akademik;
 - d) Të nënshkruaj kontrata me personelin akademik të BPrAL Kolegji UBT;

- e) Në bashkëveprim me Bordin e BPrAL Kolegji UBT, të shpallë tituj akademikë dhe tituj nderi në emër të BPrAL Kolegji UBT;
- f) Të udhëheqë me Këshillin Akademik;
- g) Të formojë komisione këshilluese akademike dhe shkencore të përkohshme në kuadër të BPrAL Kolegji UBT.
- h) Të angazhohet që politikat akademike të Këshillit Akademik të barten për implementim në Bordin e BPrAL Kolegji UBT, si dhe
- i) Kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë Statut dhe Ligj..

Këshilli Drejtues

Neni 31.

1. Këshilli Drejtues i BPrAL Kolegji UBT (më tej: Këshilli Drejtues) është organ qeverisës i BPRAL KOLEGJI UBT.
2. Këshillin Drejtues e kryeson Presidenti i Bordit të BPrAL Kolegji UBT, kurse në mungesë të tij Zv. Presidentin.
3. Këshillin Drejtues e përbëjnë, përveç Presidentit dhe Rektorit, edhe nga një përfaqësues nga secila njësi akademike e BPrAL Kolegji UBT, dhe përfaqësues nga njësitë qendrore administrative të BPrAL Kolegji UBT (Sekretari, sigurimi i cilësisë, zyrtari i lartë për financa dhe një zyrtar i lartë për çështje të studentëve). Në mbledhjet e këshillit mund të marrë pjesë një përfaqësues i studentëve, nëse këtë e vlerëson të nevojshme Kryetari i Këshillit Drejtues ose është kërkesë e organizatës studentore.
4. Këshilli Drejtues emërohet për një periudhë kohore dy (2) vjeçare, me mundësi të riemërimit.

Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

Neni 32.

1. Në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, Këshilli Drejtues ka këto funksione:
 - a) Zbatimin e vendimeve të Bordit dhe komisioneve të tij;
 - b) Bashkërendimin e veprimeve të nevojshme ndërmjet Këshillit Akademik, Rektoratit, Bordit të BPrAL Kolegji UBT, për zhvillimet akademike dhe strategjike të BPrAL Kolegji UBT;
 - c) Merr vendime për çështje zhvillimore dhe të regjistrimit, të pushimeve dhe të provimeve në bazë të propozimit të Rektoratit;
 - d) Miraton orarin e sesioneve, afatin e regjistrimit, të pushimeve dhe provimeve në bazë të propozimit të Rektoratit;
 - e) Bën komente në propozimet e Rektoratit dhe angazhohet në punët që kanë të bëjnë me Këshillin Akademik dhe Bordin e BPrAL Kolegji UBT;
 - f) Zhvillimin e gjithmbarshëm të BPrAL Kolegji UBT, sigurimin dhe ngritjen e cilësisë së punës në BPrAL Kolegji UBT, zhvillimin dhe implementimin e strukturave moderne organizative në BPrAL Kolegji UBT;
 - g) Mbikëqyrjen dhe kontrollimin e të gjitha zhvillimeve në BPrAL Kolegji UBT dhe jashtë tij, e që kanë të bëjnë me funksionimin sa më efikas të tij;
 - h) Harton planin zhvillimor, planin e biznesit, planin vjetor dhe raportin vjetor të punës, si dhe të gjitha funksionet tjera të përcaktuara me këtë Statut.
2. Procedurat për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues vendosen nga vetë Këshilli Drejtues.

24

Sekretari i BPrAL Kolegji UBT

Neni 33.

1. Sekretari i BPrAL Kolegji UBT është zyrtari më i lartë për çështje administrative dhe juridike i BPrAL Kolegji UBT, me të drejtat dhe përgjegjësitë e përshkruara për vendin e tij të punës.
2. Sekretari emërohet nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT. Sekretari duhet të jetë person me kualifikim dhe përvojë të lartë për punë për këtë pozitë.
3. Sekretari emërohet me procedure zgjedhore për një mandat periudhe kohore prej tre (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

Përgjegjësitë e Sekretarit të BPrAL Kolegji UBT

Neni 34.

1. Për punën e vet Sekretari i përgjigjet Bordit dhe Këshillit të BPrAL Kolegji UBT dhe nëse nuk tregon rezultate në punë, mund të shkarkohet nga detyra para skadimit të kontratës, bazuar në procedurat e perceptuara me ligje përkatëse.
2. Sekretari është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative - juridike në BPrAL Kolegji UBT.
3. Përgjegjësitë parësore të sekretarit janë:
 - a) Është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera juridike të BPrAL Kolegji UBT, si dhe për përkrahje profesionale administrative – juridike të njërive akademike;
 - b) Është përgjegjës për koordinimin e zyrave dhe të shërbimeve të BPrAL Kolegji UBT, mbështet organizimin e aktiviteteve mësimore shkencore në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të lëshuara nga Presidenti, Rektorit, Zëvendës Rektorit, Dekanët e fakulteteve, si dhe mbikëqyr realizimin e tij;
 - c) Është përgjegjës për menaxhimin, planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe raportimin e mbajtjes së provimeve në afatet e rregullta në BPrAL Kolegji UBT, në përputhje me rregulloret e provimeve dhe udhëzimeve të tjera, definuar nga BPrAL Kolegji UBT;
 - d) Është përgjegjës për menaxhimin e dokumentacioneve zyrtare dhe arkivit të BPrAL Kolegji UBT;
 - e) Mbikëqyr realizimin e bashkëpunimit me institucionet apo subjektet tjera vendore ose të huaja (detyrimet dhe përgjegjësitë), sipas udhëzimeve të përgjithshme dhënë nga Presidenti dhe Rektori;
 - f) Merr pjesë në hartimin e planeve zhvillimore;
 - g) Harton dhe i paraqet Rektorit planin kalendarik të procesit mësimor të BPrAL Kolegji UBT.

Përfundimi i mandatit

Neni 35.

Mandati i Sekretarit të BPrAL Kolegji UBT mund të përfundojë para kohe me vendim të Bordit, në rast dorëheqjeje ose me vendim të drejtpërdrejtë të Bordit të BPrAL Kolegji UBT, për arsye të forta siç janë:

- a) Nëse dënohet për vepër penale sipas ligjeve pozitive në fuqi;
- b) Nëse kryen veprime apo sjellje që diskreditojnë BPrAL Kolegji UBT;
- c) Nëse nuk mund të ushtrojë funksionin për shkak të gjendjes së vështirë fizike dhe psikike, të vërtetuara nga mjeku i caktuar nga BPrAL Kolegji UBT, dhe
- d) Nëse refuzon kryerjen e detyrave të punës, zvarrit ose tregon paaftësi në vazhdimësi për kryerjen e detyrave të parapara të punës.

2.11

Mbledhjet e Rektoratit

Neni 36.

1. Procedurat e mbledhjeve të Rektoratit i përcakton Rektori, me anë të një rregulloreje të veçantë të miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Rregullorja do të përfshijë procedurat për thirrje dhe mënyrat e udhëheqjes së mbledhjeve, mënyrën e marrjes së vendimeve, arkivimin dhe ruajtjen e materialeve me rëndësi për BPrAL Kolegji UBT.

Bordi i BPrAL Kolegji UBT

Neni 37.

1. Bordi i BPrAL Kolegji UBT (më tej: Bordi) është organi më i lartë vendimmarrës i BPrAL Kolegji UBT. Bordi përbëhet nga:
 - a) *Presidenti i BPrAL Kolegji UBT – i cili njëkohësisht është Kryetar i Bordit.*
 - b) *Dy (2) anëtarë, të cilët mund të mos jenë qytetarë të Kosovës, të emëruar nga themeluesi i BPrAL Kolegji UBT;*
 - c) *Tre (3) anëtarë të personelit të BPrAL Kolegji UBT, të emëruar nga themeluesi i BPrAL Kolegji UBT;*
 - d) *Tre (3) anëtarë, qytetarë të Kosovës, të cilët nuk janë personel ose studentë të BPrAL Kolegji UBT të propozuar nga Bordi, emërohen nga themeluesi i BPrAL Kolegji UBT, duke përfshirë këtu edhe Nënkryetarin e Bordit.*
2. Të gjithë anëtarët e Bordit të BPrAL Kolegji duhet të kenë përvojë në fushën e arsimit të lartë, të kenë treguar njohuri të gjerë në lëmi ekonomike, ato industriale, të tregut ose të punësimit apo përvojë në ndonjë profesion (sferë) tjetër.
3. Anëtarët e Bordit kanë mandat fillestar për një periudhë dy (2) vjeçare, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
4. Nënkryetari i Bordit zgjidhet nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT, me propozim të Kryetarit të Bordit.
5. Bordi ka për detyrë që, pas konsultimeve me përfaqësuesit e stafit, dhe në bazë të obligimeve të cilat i sigurojnë stafit akademik të BPrAL Kolegji UBT lirinë akademike për të shfaqur ide të reja dhe mendime të ndryshme, duke mos rrezikuar vendin e punës ose privilegjet në BPrAL Kolegji UBT, të miratojë rregullore lidhur me:
 - a) *Sjelljen e personelit;*
 - b) *Procedurat për t'iu krijuar anëtarëve të personelit mundësinë për të bërë ankesa lidhur me vendin e punës;*
 - c) *Suspendim ose shkarkim nga puna të anëtarëve të personelit;*
 - d) *Ankesat kundër çdo suspendimi ose shkarkimi.*
6. Të përcaktojë shumën e pagesës së shkollimit dhe pagesave të tjera në BPrAL Kolegji UBT.
7. Të nxjerrë rregulla në lidhje me qeverisjen, sjelljen dhe menaxhimin e BPrAL Kolegji UBT sipas Statutit.
8. Të sigurojë se të gjitha organet e BPrAL Kolegji UBT garantojnë mundësi të barabarta në punësim, qasje të barabartë në studime dhe punë kërkimore, pavarësisht nga gjinia, raca, orientimi seksual, statusi social, ngjyra, përkatësia etnike dhe kombëtare, bindjet politike apo fetare, si dhe mosha dhe gjendja fizike dhe psikike.
9. Bordi vendos për formën dhe përmbajtjen e flamurit, vulës, simboleve dhe diplomës, në pajtim me ligjet

pozitive në fuqi në Kosovë.

10. Për çdo vendim të Bordit, në lidhje me çështjet në vijim, nevojitet $\frac{3}{4}$ e votave të anëtarëve me të drejtë vote, duke përfshirë të paktën një anëtar të emëruar sipas dispozitës së nenit 32 alineja 2 paragrafi nën (a) dhe (c), dhe atë:

- a) *Ndryshim plotësimet e këtij Statuti;*
- b) *Ndërrimin e veprimtarisë së I BPrAL Kolegji UBT apo bashkimin me ndonjë institucion tjetër,*
- c) *Çështje të tjera të përcaktuara nga Bordi.*

Përtëritja e mandatit

Neni 38.

1. Pas mbarimit të mandatit, riemërimi i tyre ose emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit, bëhet sipas dispozitës së nenit 32 të këtij Statuti.
2. Dispozita e nenit 32 alineja 2 paragrafi nën (a) dhe (c) të këtij Statutit do të aplikohen si *mutatis mutandis* për anëtarët pasardhës të Bordit.
3. Çdo anëtar pasardhës i Bordit të BPrAL Kolegji UBT do të kryejë një mandat dyvjeçar, me mundësi vazhdimi.
4. Periudha e ushtrimit të detyrës së Nënkryetarit do të jetë në përputhshmëri me periudhën e anëtarësisë së tij në Bord.
5. Çdo anëtar i emëruar sipas nenit 32 alineja 2 paragrafi nën (a) dhe (c) ose sipas dispozitave të këtij neni, mund të përfundojë mandatin edhe para kohe me vendim të Themeluesit ose me $\frac{2}{3}$ e votave të Bordit, në këto raste:
 - a) *Nëse ka qenë i dënuar për shkelje penale sipas ligjeve pozitive në fuqi në Kosovë;*
 - b) *Nëse ka bërë veprime që e diskreditojnë BPrAL Kolegji UBT;*
 - c) *Nëse nuk mund ta ushtrojë funksionin për shkak të gjendjes së vështirë fizike dhe psikike, të vërtetuar me raport mjekësor nga mjeku apo komisioni i mjekëve të autorizuar, dhe*
 - d) *Nëse refuzon punët dhe detyrat e punës, zvarrit ose tregon paaftësi në vazhdimësi për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.*

Presidenti i Bordit

Neni 39.

1. Presidenti do të udhëheqë me Bordin e BPrAL Kolegji UBT.
2. Nënkryetari do të udhëheqë me Bordin e BPrAL Kolegji UBT në rast mungesë të Presidentit, si dhe do të ushtrojë të gjitha funksionet e Presidentit gjatë sëmundjes ose në rast të ndonjë mosfunksionimi tjetër të Presidentit.
3. Presidenti i Bordit të BPrAL Kolegji UBT do të ketë të drejtën e vetos origjinale dhe votës vendimtare.
4. Presidenti dhe anëtari tjetër i Bordit të BPrAL Kolegji UBT, përveç me prezencën e tyre fizike, mund të marrin pjesë në aktivitetin e Bordit edhe në mënyra të tjera sipas Rregullores së Bordit.
5. Presidenti i Bordit, në mungesë të Nënkryetarit, mund t'ia kalojë një anëtar tjetër të Bordit, i emëruar në

8.11

mbështetje të nenit 32 alineja 2 paragrafi nën (a), përgjegjësitë e kryerjes së detyrës së Kryetarit sipas këtij Statuti, duke marrë parasysh se çdo veprim i kryer sipas kësaj dispozite do të raportohet në mbledhjen vijuese të Bordit.

6. Përveç kësaj, Presidenti i Bordit kujdeset:

- a) *Të udhëheqë Këshillin Drejtues të BPrAL Kolegji UBT;*
- b) *Të aprovoje dhe mbikqyre strategjinë e Institucionit, duke përfshirë edhe financat, resurset humane, infrastrukturën, prokurimin dhe marketingut e institucionit;;*
- c) *Të punësojë personelin e BPrAL Kolegji UBT;*
- d) *Të formojë komisione këshilluese të përkohshme në kuadër të BPrAL Kolegji UBT.*
- e) *Përfaqësimin dhe prezantimin e BPrAL Kolegji UBT para opinionit të gjerë publik;*

Mbledhjet

Neni 40.

Procedurat për mbledhjet e Bordit do të përcaktohen nga vetë Bordi i BPrAL Kolegji UBT. Puna e Bordit rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Bordi.

VII. STRUKTURA AKADEMIKE

Njësitë akademike

Neni 41.

BPrAL Kolegji UBT përbëhet prej njësive akademike që janë: fakultetet, departamentet, institutet, qendrat, degët, njësit, etj.. Njësitë akademike veprojnë në kuadër të juridiksionit të BPrAL Kolegji UBT, duke ofruar programe të arsimit të lartë dhe projekte të ndryshme që i mbulon.

Fakultetet

Neni 42.

1. Fakulteti është njësi akademike e BPrAL Kolegji UBT që angazhohet për mësimdhënie dhe punë kërkimore në fusha të veçanta akademike ose në fusha të tjera të ngjashme.
2. Fakulteti është përgjegjës:
 - a) *Për mësimdhënie, kontrollim dhe vlerësim të studentëve, punës shkencor dhe profesionale;*
 - b) *Për çështjet të cilat kanë të bëjnë me përparimin akademik të studentëve;*
 - c) *Për të bërë propozime Këshillit Akademik në lidhje me çështjet akademike të lëndëve të ligjëruara në Fakultet;*
 - d) *Për çështjet e personelit në bazë të këtij Statuti;*
 - e) *Për përdorim efikas dhe të saktë të burimeve të përcaktuara nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT.*
3. Numri dhe lëndët në Fakultete do të përcaktohen nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT, me propozim të Këshillit Akademik dhe Këshillit Drejtues.
4. Numri i fakulteteve në BPrAL Kolegji UBT do të përcaktohet nga Rektorati i BPrAL Kolegji UBT sipas propozimeve të ofruara nga Këshilli i fakultetit dhe Dekani, me pëlqim paraprak të Bordit.
5. Fakultetet, varësisht nga kërkesat zhvillimore, mund të ndahen ose të bashkohen ose të ketë departamente dhe njësi të tjera.

Udhëheqja e Fakultetit

Neni 43.

1. Çdo Fakultet do të udhëhiqet nga Dekani, i cili me miratim të Bordit të BPrAL Kolegji UBT mund të ketë një Zëvendës.
2. Bazuar në dispozitat e këtij Statuti, Dekani dhe Zëvendës Dekani i Fakultetit emërohen nga Rektori i BPrAL Kolegji UBT, paraprakisht të përzgjedhur nga Këshilli i Fakultetit përkatës dhe të miratuar nga Këshilli i Drejtues.
3. Emërimi i Dekanit dhe Zëvendës Dekanit të Fakultetit do të zgjasë tre (3) vjet me mundësi të rizgjedhjes.
4. Kandidatet që konkurrojnë paraqesin programet e tyre para Këshillit të Fakultetit.
5. Kandidatet të cilët zgjidhen duhet të jenë persona me kualifikime dhe përvojë relevante akademike dhe menaxhuese.
6. Dekani duhet të ketë minimumin gradë shkencore të Doktorit të shkencave.
7. Kandidatët për postin e Dekanit ose Zëvendës Dekanit të Fakultetit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe kandidatë për postin e Rektorit.
8. Procedura për zgjedhje do të rregullohet me Rregullore të veçantë.
9. Dekani mbanë përgjegjësi para Rektorit, Këshillit Drejtues të BPrAL Kolegji UBT dhe Këshillit të Fakultetit.
10. Detyrat e Dekanit janë:
 - a) Të sigurojë udhëheqje akademike në lëndët e ligjëruara në Fakultet, në mësimdhënie dhe në punë shkencore;
 - b) Të sigurojë përdorimin efikas, ekonomik dhe të saktë të burimeve të ndara për Fakultet nga Rektorati dhe Bordi;
 - c) Të përfaqësojë Fakultetin në Këshillin Akademik dhe në Këshillin Drejtues;
 - d) Të këshillojë Rektorin për emërimet e personelit akademik në lëndët e ligjëruara në Fakultetin përkatës;
 - e) Të bëjë organizimin e punës akademike, shkencore dhe punëve tjera në kuadër të Fakultetit;
 - f) Të ushtrojë edhe detyrat të tjera të parapara me Statut.

Zëvendës Dekani dhe Koordinatori

Neni 44.

1. Secili Fakultet ka nga një Dekan, në mënyrë specifike mund të përcaktohet edhe Zëvendës Dekan, Udhëheqës Departamenti apo Koordinator, nëse kështu vendos Bordi.
2. Në mungesë të Dekanit përfaqësimin në Këshillin Drejtues dhe në Këshillin Akademik e merr Zëvendës Dekan, Udhëheqës Departamenti apo Koordinator.

Mandati

Neni 45.

1. Mandati i Dekani dhe Zëvendës Dekani mund të mbarojë para kohe, me dorëheqje ose largim nga

Presidenti ose Rektori për këto arsye:

- a) Nëse dënohet për shkelje penale sipas ligjeve të Kosovës në fuqi;
 - b) Nëse kryen veprime që e diskreditojnë BPrAL Kolegji UBT;
 - c) Nëse nuk mund të ushtrojë funksionin për shkak të gjendjes së vështirë fizike dhe psikike, të vërtetuar me raport mjekësor nga mjeku apo komisioni i mjekëve të autorizuar, dhe
 - d) Nëse refuzon detyrat e punës, zvarrit ose tregon paaftësitë në vazhdimësi për kryerjen e detyrave të parapara të punës.
 - e) Për shkak të ndryshimeve strukturore, strategjive të reja për zhvillim.
 - f) Shkrirjes, bashkimit ose shuarjes së funksioneve – organeve përkatëse.
2. Nëse Presidenti ose Rektori suspendon nga puna Dekani për shkak të shkeljes së ligjit, akteve nënligjore apo Statutit të BPrAL Kolegji UBT, vendimin mbi suspendimin e vërteton Bordi i BPrAL Kolegji UBT në afat prej 30 ditësh nga suspendimi nga ana e Presidenti ose Rektorit. Nëse edhe Bordi vërteton suspendimin, nënkupton se Dekani është shkarkuar nga detyra e tij ditën e miratimit të vendimit mbi vërtetimin e suspendimit.
 3. Nëse Dekani shkarkohet nga detyra, Rektori me propozim të Bordit emëron ushtruesin e detyrës së Dekanit deri në zgjidhjen e Dekanit të ri. Procedura për zgjedhjen e Dekanit të ri procedohet në përputhje me ligjin dhe këtë Statut. Në raste të këtilla Dekani i shkarkuar nga detyra nuk mund të rizgjidhet.

Këshilli i Fakultetit

Neni 46.

1. Çdo Fakultet ka Këshillin e Fakultetit.
2. Këshilli i Fakultetit do të përbehet nga Dekani dhe dy (2) anëtarë të personelit akademik të Fakultetit përkatës, dy (2) përfaqësues të studentëve të deleguar nga studentët e të gjitha niveleve të Fakultetit përkatës me mandat një (1) vjeçar, një (1) përfaqësues nga Biznesi apo Institucionet dhe një (1) anëtar i Alumnit.
3. Përgjegjësitë kryesore të Këshillit të Fakultetit janë:
 - a) Të diskutoj çështje të përgjithshme në lidhje me planprogramet e studimeve, punën kërkimore shkencore, regjistrimin e studentëve (numrin dhe kriteret) dhe lëndët mësimore në Fakultet;
 - b) Të shqyrtoj dhe të propozoj planprogramet e studimeve;
 - c) Të shqyrtoj dhe të propozoj gjuhën në të cilën zhvillohen studimet;
 - d) Të propozoj rregulla dhe procedura të vlerësimit për sigurimin e cilësisë në studimet akademike;
 - e) Të rishikoj dhe vlerësoj e përmbajtjet e programeve të lëndëve mësimore;
 - f) Të propozoj rregulla, kritere dhe procedura të vlerësimit të shkallës së arritshmërisë së studentëve;
 - g) Të propozoj çështje zhvillimore dhe të regjistrimit, të pushimeve dhe të provimeve;
 - h) Të bëjë komente në propozimet e Rektoratit dhe Këshillit Akademik, atëherë kur kërkohet prej tij;
 - i) Të diskutojë dhe të propozoj çështje të cilat kanë të bëjnë me avancimin e procesit të studimeve;
 - j) Të bëjë propozime Këshillit Akademik në lidhje me çështjet akademike të lëndëve të ligjëruara në Fakultete;
 - k) T'i bëjë propozime Këshillit Akademik për çështjet e personelit në bazë të këtij Statuti;
 - l) Të zgjedh përfaqësuesin e vetë në Këshillin Akademik të BPrAL Kolegji UBT;
 - m) Të këshillojë, të diskutojë dhe të jap propozime për emërimet e personelit akademik në lëndët e ligjëruara në fakultetet përkatës;
 - n) Të ushtrojë edhe detyrat të tjera të parapara me Statut.

Njësitë tjera akademike

Neni 47.

1. Numri dhe funksioni i njësive të tjera akademike të BPrAL Kolegji UBT (institucionet e punës kërkimore dhe shkencore dhe profesionale, institutet, qendrat e ekselencës etj.), do të përcaktohen nga Këshilli Drejtues i BPrAL Kolegji UBT me pëlqim dhe pas konsultimeve me Bordin.
2. Këto njësi organizative të formuara mund të ndahen ose të bashkohen.
3. Secila njësi akademike, e formuar në bazë të këtij neni, do të jetë pjesë integrale e BPrAL Kolegji UBT dhe nuk mund të paraqitet si njësi juridikisht e pavarur.
4. Numri i fakulteteve dhe pozitave të punës në çdo njësi do të përcaktohet nga Bordi me propozim të Rektorit.

Drejtori dhe Menaxheri

Neni 48.

1. Çdo njësi do të udhëhiqet nga një drejtor ose menaxher.
2. Drejtori ose menaxheri emërohet nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT, sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi.
3. Drejtori ose menaxheri mban përgjegjësi para Bordit.
4. Detyrat e Drejtori ose menaxheri janë:
 - a) Të menaxhojë njësitë organizative duke mundësuar përdorimin efikas dhe ekonomik të burimeve të ndara për të nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT;
 - b) Të përfaqësojë njësitë organizative në Këshillin Akademik dhe në Këshillin Drejtues;
 - c) Të këshillojë Rektoratit në lidhje me emërimet e anëtarëve të stafit në njësine organizative;
 - d) Të ushtrojë detyrat e tjera të cilat i takojnë Drejtorit ose menaxherit, të parapara me Statut.
5. Drejtori ose menaxheri mund të përfaqësojë njësine akademike me autorizim të posaçëm të Bordit nëpërmjet Rektoratit.
6. Mandati i Drejtori ose menaxheri mund të mbarojë para kohe me dorëheqje ose largim nga Bordi, për këto arsye:
 - a) Nëse dënohet për shkelje penale sipas ligjeve të Kosovës në fuqi;
 - b) Nëse kryen veprime që e diskreditojnë BPrAL Kolegji UBT;
 - c) Nëse nuk mund të ushtrojë funksionin për shkak të gjendjes së vështirë fizike dhe psikike, të vërtetuar me raport mjekësor nga mjeku apo komisioni i mjekëve të autorizuar, dhe
 - d) Nëse refuzon detyrat e punës, zvarrit ose tregon paaftësitë në vazhdimësi për kryerjen e detyrave të parapara të punës.
 - e) Për shkak të ndryshimeve strukturore, strategjive të reja për zhvillim.
 - f) Shkrirjes, bashkimit ose shuarjes së funksioneve – organeve përkatëse.

VIII. STRUKTURA E STUDIMEVE DHE KËRKIMEVE

Plani dhe Programet

Neni 49.

1. BPrAL Kolegji UBT organizon procesin mësimor në bazë të planit dhe programit mësimor të akredituar nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës dhe atyre ndërkombëtare.
2. Përmbajtja e planprogrameve mësimore propozohet nga Këshillat e Fakultetit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe miratohen në Këshillin Akademik.

Shkalla e studimeve

Neni 50.

1. Studimet për diplomë të BPrAL Kolegji UBT të nivelit IV, V, VI, VII, VIII, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve zgjasin në përputhje me periudhën e përcaktuar në Planin dhe Programin, dhe Sistemin Evropian të Kredive (ECTS), sipas standardeve globale.
2. Studentët duhet të përfundojnë studimet e tyre në përputhje me ECTS-të e paraparë në programin e studimeve.
3. Studimet në programet në diplomë të përbashkëta, diplomë të dyfishta, diplomë të kombinuar, diplomë profesionale dhe shkollimi gjatë gjithë jetës, certifikimet, trajnimet, etj. përcaktohen me planin dhe programin e miratuar nga Këshilli Akademik, si për nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja.
4. Studimet për doktoratë (shkalla e tretë) zgjasin gjashtë (6) semestra apo tre (3) vite akademike, me gjithsej 180 kredi sipas sistemit evropian për transfero të kredive (ECTS).
5. Mënyra e mbikëqyrjes së punës kërkimore dhe vlerësimi për kandidatët për doktoratë përcaktohet me rregullore të veçantë miratuar nga Këshilli Akademik.
6. Rektori në rastet e kërkesës së studentëve të arsyetuara, mund të zgjatë afatin e diplomimit për periudhën për të cilën kanë ekzistuar arsye për moskryerje të detyrimeve që dalin nga programi i studimeve nga ana e studentit.

Vlerësimi

Neni 51.

1. Mënyra e vlerësimit e shkallës së arritshmerisë gjatë studimeve për diplomë të BPrAL Kolegji UBT do të përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Akademik.
2. Suksesi i arritur në studime vlerësohet në bazë të kriterëve profesionale dhe shkencore të përcaktuara me planprogramin mësimor.
3. Suksesi shprehet me notë përkatëse në bazë të përqindjes së arritjes sipas kriterëve të përcaktuara me plan programin mësimor. Nota shkruhet me shkronja dhe shpreh barasvlerën e përqindjes së caktuar me dokument të veçantë për barasvlerën e notave me shkallën e arritshmerisë në përqindje.
4. Studentët vlerësohen gjatë gjithë vitit akademik dhe zyrtarisht i nënshtrohen provimeve në lëndët e paraqitura në periudha të rregullta dhe të veçanta të miratuara nga Këshilli Akademik.

Dokumentet akademike publike

Neni 52.

1. Në bazë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, BPrAL Kolegji UBT lëshon dokumente relevante akademike gjatë studimeve (vërtetime dhe certifikata të notave), por edhe me rastin e mbarimit me sukses të studimeve themelore, të studimeve pasdiplomike, si dhe të shkallës të tjera.
2. BPrAL Kolegji UBT në këto raste lëshon këto dokumente:
 - a) *Certifikatë;*
 - b) *Diplomë për Programe Ekzekutive*
 - c) *Diplomë për studime Bachelor;*
 - d) *Diplomë për Studime Master;*
 - e) *Diplomë për Studime Doktorature;*
 - f) *Diploma të Përbashkëta, Diploma të Dyfishta (në bazë të marrëveshjes me institucionet partnere);*
 - g) *Diplomë plotësuese (Diploma Supliment), si dhe*
 - h) *Dokumentacion tjetër të paraparë me ligj.*

Titujt Akademikë

Neni 53.

1. Titujt akademikë përcaktohen nga Këshilli Akademik në mënyrë që të jenë të përshtatshëm me praktikën akademike dhe profesionale ndërkombëtare dhe mund të ndryshojnë nga fakulteti në fakultet.
2. Bordi mund të japë titullin e anëtarit të nderit të BPrAL Kolegji UBT çdo personi, i cili në opinionin e tij ka kryer një shërbim me interes për BPrAL Kolegji UBT.

Pranimi

Neni 54.

1. Rektori, me propozim të Këshillit Akademik, si dhe duke e vlerësuar nevojën e institucionit bën pranimin e stafit për vende të lira të punës.
2. Emërimin e stafit akademik e bën Rektori i BPrAL Kolegji UBT.
3. Stafi akademik e lidh marrëdhënien e punës me anën e një kontrate, e cila mund të jetë me orar të plotë dhe me orar jo të plotë të punës, si dhe sipas nevojave specifike.

Kushtet

Neni 55.

1. Kërkesat për emërim dhe promovim, në çdo nivel të stafit akademik, janë kualifikimet dhe përvoja relevante akademike për pozicionin që do ta mbajë:
 - a) *Për titull Profesor, kandidati duhet të ketë të paktën gradën shkencore të doktoratës ose ndonjë shkallë të barasvlershme dhe të demonstrojë nivelin e lartë të njohurisë për lëmin e studimit. Kjo njohuri duhet të jetë e evidentuar me publikime në revistat shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera hulumtuese shkencore dhe dëshmi për udhëheqje akademike;*
 - b) *Për titullin Asistent Profesor, kandidati duhet të ketë shkallën e doktoratës ose ndonjë shkallë të barasvlershme, të ketë publikime në revista shkencore ndërkombëtare, të ketë bërë punë artistike ose prezantime publike, të*

24

demonstrojë aftësi ligjërimi, si dhe të dëshmojë për punimet shkencore dhe zotërim të lëndës në fushën përkatëse;

- c) Për titull Asistent, kandidati duhet të jetë kompetent në ligjërime ose punë kërkimore dhe të ketë shkallën e magjistraturës, dhe*
- d) Kriteret më të hollësishme për kriteret dhe mënyrën e dhënies së titujve akademike përcaktohen me Rregullore të veçantë.*

Kohëzgjatja dhe përtëritja e kontratës

Neni 56.

1. Profesorit të pensionuar nga Bordi mund t'i jepet grada e Profesorit Emeritus, apo edhe të angazhohet në projekte kërkimore. Detyrat e këtyre profesorëve do të caktohen me kontratë individuale.
2. Skema për "pushim të merituar - sabbatikus" deri në një vit për stafin akademik do të caktohet nga Bordi pas konsultimit me Këshillin Akademik.

Ndërprerja e kontratës

Neni 57.

Rektori, kur për këtë ka arsye të fortë, në përputhje me nenin 40 dhe shkeljen e rëndë të kodit etik të mësimdhënësve, mund të ndërpresë kontratën me një anëtar të stafit akademik, duke u bazuar në nenin paraprak.

IX. STUDENTËT

Sendërtimi i statusit të studentit

Neni 58.

1. Student është personi i regjistruar në studime në BPrAL Kolegji UBT.
2. Statusin e tij studenti e dëshmon në bazë të dokumentit përkatës, formën e të cilit e percepton Këshilli Akademik.
3. **Studentët e rregullt, me korrespondencë, si dhe në distancë**
4. Studentët mund të jenë të rregullt, me korrespondencë, si dhe në distancë.
5. Studentë të rregullt janë ata studentë, të cilët studiojnë sipas planprogrameve që bazohen në studime, mirëpo në kohë jo të plotë.
6. Student me korrespondencë dhe në distancë janë studentët të cilët studiojnë programin e njëjtë me orar jo të plotë, ndërsa forma është e përcaktuar më rregullore.
7. Statusin e studentit të rregullt, me korrespondencë, si dhe studentit me distancë e ka studenti gjatë gjithë kohës sa është paraparë kohëzgjatja e studimeve e përcaktuar me rregullore.
8. Studentët e rregullt si dhe studentët me korrespondencë i bartin në tërësi shpenzimet e studimeve në përputhje me aktet e veçanta të BPrAL Kolegji UBT.

Pranimi i studentëve

Neni 59.

1. Pranimi i studentëve në studime bëhet në bazë të rregullores të miratuar nga Këshilli Akademik, në përputhje me këtë Statut.
2. Rregullorja përfshin dispozitat për kriteret e regjistrimit të studentëve të rinj dhe dispozitat për pranimin e studentëve të transferuar nga institucionet tjera të arsimit të lartë, me kusht që secili student i transferuar që dëshiron të diplomojë në BPrAL Kolegji UBT, është i detyruar të kalojë minimumin një vit të tërë akademik në BPrAL Kolegji UBT.
3. Numri i studentëve caktohet nga Këshilli Akademik për çdo vit kalendarik dhe për secilën njësi akademike (60 ECTS) në bazë të një plani të aprovuar nga Rektori.

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 60.

1. Studentët e pranuar në BPrAL Kolegji UBT kanë të drejtë:
 - a) Të marrin pjesë në të gjitha leksionet, seminarët dhe në ligjërime të tjera të organizuara në lëndët e tyre sipas pozitës së tyre;
 - b) Të përdorin objektet e bibliotekës, si dhe shërbimet tjera për studentë;
 - c) Të marrin pjesë për zgjedhje për pozita të studentëve në organet e BPrAL Kolegji UBT;

- d) Për studim cilësor dhe proces arsimor sipas programeve adekuate studimore;
 - e) Në mendimin e lirë dhe paraqitjen e ideve personale;
 - f) Në pjesëmarrje në projektet profesionale në përputhje me aftësitë e tij dhe nevojat e BPrAL Kolegji UBT;
 - g) Në konsultime;
 - h) Në zgjedhjen e profesorit për dhënie të provimit, nëse BPrAL Kolegji UBT ka me shumë profesorë të atij profili;
 - i) Në organizimin e aktiviteteve sportive me qëllim të përgatitjes psikofizike të studentit;
 - j) Në pjesëmarrje në punën e organizatave studentore në përputhje me rregullat e tyre;
 - k) Në paraqitjen e kundërshtimeve apo ankesave organeve përkatëse të BPrAL Kolegji UBT, nëse i janë shkelur të drejtat studentore;
 - l) Të marrin kartelat e identifikimit;
 - m) Në fund të vitit akademik, të marrin certifikatën e notave akademike.
2. Studentët kanë obligim:
- a) Të zbatojnë rregulloret dhe rendin shtëpiak të BPrAL Kolegji UBT;
 - b) Të respektojnë personelin dhe të drejtat e studentëve të tjerë;
 - c) Të përcejllin me rregull dhe disiplinë akademike procesin mësimor, si dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
 - d) Të kryejnë obligimet e parapara me kontratën e studimeve;
 - e) Të sillen mirë, brenda dhe jashtë mjedisit të BPrAL Kolegji UBT, në mënyrë që të krijojnë dhe ta ruajnë imazhin e mirë për BPrAL Kolegji UBT;
 - f) Të vijojnë mësimin rregullisht, të kryejnë detyrat e parapara me programe studimore dhe akte të posaçme të BPrAL Kolegji UBT;
 - g) Të marrin pjesë në vlerësimin e cilësisë së mësimin dhe mësimdhënësve në formën dhe mënyrën e paraparë me akte të BPrAL Kolegji UBT;
 - h) Të regjistrojnë semestrin e radhës ose vitin nëse i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara me plane dhe programe studimore;
 - i) Të kalojnë provimet në mënyrë dhe afate të parapara me akte të përgjithshme dhe akte të veçanta të BPrAL Kolegji UBT dhe njësive akademike, dhe
 - j) Të përfundojnë studimet sipas programeve të perceptuara në afatet e paraparë me akte të përgjithshme të BPrAL Kolegji UBT.
3. Studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e mësimdhënies, për kushtet dhe shërbimet tjera nga ana e BPrAL Kolegji UBT. Ankesat i dorëzohen fillimisht Dekani apo nëpunësit të administratës përgjegjëse për çështje të studentëve.
4. Varësisht nga lloji i tyre, kërkesat dhe ankesat shqyrtohen nga Bordi përkatës në përputhje me Rregulloren për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave, i cili merr vendim meritore në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

Ndërprerja e studimit

Neni 61.

1. Këshilli i fakultetit mund t'i propozojë Rektoratit largimin e studentit, në rast se ai/ajo dështon të përparojnë gjatë studimeve. Largimi i studentëve bëhet pas shqyrtimit paraprak nga Komisioni përkatës i emëruar nga këshilli Akademik dhe sipas procedurave të parapara me rregulloren përkatëse miratuar nga Bordi.
2. Rektori mund t'i largojë nga BPrAL Kolegji UBT, përgjithmonë ose përkohësisht, ata studentë të cilët nuk sillen mirë. Studentët të cilët akuzohen për sjellje jo edukative mund të intervistohen nga Komisioni Disiplinor, i cili pastaj do t'i propozojë Rektorit për masat që duhen të merren ndaj tyre. Largimi para intervistimit mund të autorizohet (urdhërohet) nga Rektori. Studentët e larguar mund të ushtrojnë ankesë

në Bord, i cili mund të konfirmojë ose ndryshojë vendimin e Rektorit. Rregullorja e cila i sqaron këto procedura do të përpilohet nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT me propozim të Këshillit Akademik.

3. Statusi i studentit ndërpritet (humbet) sidomos në rastet si më poshtë:

- përfundimi i studimeve,
- çregjistrimi i studimeve,
- mos regjistrimi i vitit vijues akademik (apo semestrit),
- në rastet tjera të parapara me ligj, akte nënligjore dhe Statut të BPrAL Kolegji UBT apo akte të posaçme të njësive akademike ku studenti studion.

4. E drejta në pushim të detyrimit. E drejta në pushimin e detyrimit të studentit sendërtohet në rastet si në vijim:

- gjatë shtatzënisë,
- për studente nënë apo edhe student baba deri në një vit të vjetërsisë së fëmijës së lindur,
- në raste të tjera të parapara me ligj, akte nënligjore dhe Statut të BPrAL Kolegji UBT.

5. Bazuar në kushtet e theksuara më lart, studentit mund t'i vazhdohet periudha e studimeve, varësisht prej kohëzgjatjes së ekzistimit të rrethanave të cilat kanë penguar vijimin e rregullt të studimeve.

Viti akademik

Neni 62.

1. BPrAL Kolegji UBT organizon studime në programet e miratuara të studimit gjatë një viti akademik.
2. Viti akademik mund të zgjatë jo më pak se shtatë muaj dhe jo më shumë se 12 muaj.
3. Viti akademik për studime bazë fillon varësisht nga programi i studimit, më 1 tetor dhe më së voni më 1 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik, si dhe përfundon më 30 shtator, respektivisht më 30 nëntor të vitit vijues kalendarik. Kjo rregull nuk do të thotë të vlejë për programet Master ose të doktoratës, të cilat mund të fillojnë në çdo semestër, varësisht nga vendimi i Rektoratit dhe Këshillit Akademik.
4. Procesi mësimor (ligjëratat, seminarët etj.) është i ndarë në dy semestra: Semestri Dimëror dhe Semestri Veror.
5. Kalendarin e studimeve e miraton Këshilli Akademik me propozimin e Rektoratit.

Gjuha e studimeve

Neni 63.

1. BPrAL Kolegji UBT organizon studime në gjuhën angleze, gjuhën shqipe dhe në disa programe edhe në gjuhë tjera.
2. Këshilli Akademik me propozimin e Rektoratit vendos për gjuhën në të cilin do të zhvillohen studimet e caktuara akademike.

Ndërrimi i drejtimit dhe i gjuhës së studimeve

Neni 64.

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit kur e ka përfunduar atë dhe e fillon programin e ri, ose kur studentit ka përfunduar ECTS nga programi paraprak të cilat pranohen në programin e ri të studimeve.

2. Në rastet e tilla, studentit i mundësohet regjistrimi në semestrin përkatës, të barasvlershëm me numrin e lëndëve të pranuar në raport me semestrin dhe numrin e kredive.
3. Studenti mund ta ndërrojë drejtimin dhe gjuhën e studimit prej njëres gjuhë në gjuhën tjetër, kur këtë e vlerëson Këshilli i fakultetit, në bazë të kërkesës së studentit, dhe pas miratimit të tij nga komisioni për transfere i BPrAL Kolegjit UBT.

X. FINANCAT

Fondet

Neni 65.

1. BPrAL Kolegji UBT është institucion arsimor jopublik.
2. Fondet i krijon nga burime të ndryshme, si:
 - a) *Donacione nga individët, shoqata ose fondacione nga brenda dhe jashtë Kosovës;*
 - b) *Pagesa e shkollimit si dhe pagesa të tjera të studentëve;*
 - c) *Grante dhe pagesa nga puna kërkimore dhe shkencore;*
 - d) *Të hyra nga zhvillimi dhe zbatimi i projekteve;*
 - e) *Shfrytëzimi i pronësisë intelektuale të BPrAL Kolegji UBT;*
 - f) *Përdorimi i objekteve të BPrAL Kolegji UBT për konferenca, seminare, mbledhje dhe aktivitete të ngjashme;*
 - g) *Kontrata për shërbime akademike dhe jo akademike, si dhe*
 - h) *Çdo lloj burimi tjetër i lejuar me ligjet e Kosovës.*

Auditimi

Neni 66.

1. BPrAL Kolegji UBT ka një njësi të pavarur të auditimit të brendshëm, e cila bën kontroll të kohëpaskohshëm për sigurimin e përdorimit të duhur të buxhetit dhe parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme financiare.
2. Njësi i auditit i raporton Bordit për mënyrën e përdorimit të fondeve financiare në BPrAL Kolegji UBT.
3. Emërimin e auditit e bën Bordi me vendim të posaçëm.
4. Auditorët e emëruar nga alineja paraprake e këtij neni nuk do të kenë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë personale ose profesionale me ndonjë anëtar të Bordit ose Këshillit të BPrAL Kolegji UBT.

XI. ADMINISTRATA

Dokumentacioni

Neni 67.

1. Sekretari i BPrAL Kolegji UBT është përgjegjës për udhëheqjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit administrativ dhe akademik të BPrAL Kolegji UBT, si dhe arkivimin e tyre, si në vijim:
 - a) *Kërkesat për regjistrim;*
 - b) *Regjistrin e studentëve të regjistruar për të gjitha programet e studimit dhe punës kërkimore;*
 - c) *Regjistrin e studentëve të diplomuar;*
 - d) *Dokumentacionin pronësor;*

- e) Listën e projekteve për punë kërkimore;
 - f) Marrëveshjet dhe kontratat e bashkëpunimit dhe projekteve;
 - g) Kopjet nga kontratat komerciale,
 - h) Planin e punës së BPrAL Kolegji UBT, dhe
 - i) Çështjet tjera sipas kërkesës së Bordit të BPrAL Kolegji UBT.
2. I gjithë personeli dhe studentet e BPrAL Kolegji UBT do të bashkëpunojnë me Sekretarin, për të siguruar informatat të cilat nevojiten sipas alinesë paraprake të këtij neni.
 3. Të gjitha dosjet personale do të ruhen me besueshmëri të plotë dhe askush nuk do të ketë qasje në dosjet personale të Sekretarit dhe punëtorit në dosjen e vet, në përputhje me Ligjin.

XII. Burimet Njerëzore

Neni 68

Burimet Njerëzore në kuadër të BPrAL Kolegji UBT, janë departament në vete, si dhe menaxhuese nëpërmjet Menaxherit të Burimeve Njerëzore, me detyrat e shënuara më poshtë;

- a) Planifikimi i kapaciteteve të nevojshme të punës;
- b) Aplikimi i praktikave dhe standardeve më të mira të rekrutimit të stafit;
- c) Specializimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- d) Planifikimin, zhvillimin dhe implementimin e politikave nga fusha e burimeve njerëzore;
- e) Mbështetja profesionale departamenteve, si dhe mekanizmave që veprojnë në kuadër të institucionit, si dhe
- f) Menaxhimi i dosjeve të personelit.

XIII. ORGANIZATAT E STUDENTËVE

Organizimi i studentëve

Neni 69.

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen dhe të themelojnë organizata studentore, me qëllim të organizimit më të mirë të procesit mësimor dhe ngritjes së cilësisë në studime, përfaqësimin e studentëve dhe mbrojtjen e interesave akademike të tyre, organizimin e jetës kulturore, artistike dhe sportive në BPrAL Kolegji UBT.
2. Studentët mund të organizohen në një apo më shumë organizata, të cilat mund të kenë në përbërjen e tyre seksione të ndryshme.
3. Organizata e studentëve themelohet dhe vepron në bazë të statutit të saj, miratuar nga Kuvendi i anëtarëve të saj dhe nga Bordi i BPrAL Kolegji UBT.
4. Statuti do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe pamundëson diskriminimit.
5. Ndryshim plotësimet në statutin e organizatës studentore i nënshtrohen të njëjtës procedurë sikur në rastin e miratimit të tij fillestar.
6. Kuvendi i përfaqësuesve të organizatave studentore do të jetë organi më i lartë vendimmarrës i organizatës së studentëve, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha njësive akademike të BPrAL Kolegji UBT, të zgjedhur në mënyrë demokratike nëpërmjet votës së fshehtë, nga i cili zgjidhen përfaqësuesit e studentëve në strukturat e BPrAL Kolegji UBT.

7. Organizata studentore e themeluar në përputhje me këtë nen do t'i emërojë në mënyrë demokratike dhe të drejtë përfaqësuesit e vet në organet e I BPrAL Kolegji UBT, përcaktuar me këtë Statut dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë.
8. Studentët kanë të drejtën të formojnë shoqata apo bashkësi të ndryshme për ato qëllime të cilat janë të lejuara me ligj dhe me këtë Statut.

XIV. PËRFAQËSIMI DHE PREZANTIMI I BPrAL KOLEGJI UBT

Përfaqësimi i BPrAL Kolegji UBT

Neni 70.

BPrAL Kolegji UBT e përfaqëson dhe e prezanton Presidenti, në të gjitha punët juridike dhe është i autorizuar që t'i lidhë të gjitha kontratat dhe punët tjera juridike, duke përfshirë këtu edhe kontratat mbi shitblerjen e patundshmërisë.

Neni 71.

1. Presidenti mund të autorizojë personin tjetër për përfaqësim apo prezantim të BPrAL Kolegji UBT.
2. Autorizimi nga alineja paraprake mund të jepet si autorizim i veçantë, i cili vlen për punë të caktuar apo si autorizim i përgjithshëm i cili vlen për të gjitha rastet.
3. Presidenti është i obliguar që të mbikëqyrë përdorimin e autorizimit për përfaqësim dhe prezantim të BPrAL Kolegji UBT.

Neni 72.

1. Presidenti si dhe personat të cilit e përfaqësojnë dhe e prezantojnë BPrAL Kolegji UBT, janë të obliguar që t'i mbrojnë interesat e BPrAL Kolegji UBT dhe të themeluesve të saj.
2. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Presidenti dhe personi i autorizuar nga ai janë të obliguar që t'i përmbahen ligjit dhe dispozitave të tjera dhe janë përgjegjës për shkelje të ligjit dhe dëmet e shkaktuar me ndërmarrjen e akteve gjatë përfaqësimit dhe prezantimit të BPrAL Kolegji UBT.

Prokura

Neni 73.

1. Presidenti i BPrAL Kolegji UBT mund t'ia japë personit të caktuar prokurën.
2. Prokura e përmban autorizimin për kontraktim dhe kryerjen e punëve dhe veprimeve juridike lidhur me të drejtat dhe detyrimet e BPrAL Kolegji UBT.
3. Prokura nuk mund të përmbajë autorizimin për tjetërsimin dhe ngarkesën e patundshmërisë së BPrAL Kolegji UBT.
4. Prokura jepet për tërë apo për njësitë e caktuara të veprimtarisë së BPrAL Kolegji UBT, çka duhet të ceket në prokurën e dhënë.

Neni 74.

1. Prokura mund të jepet si prokurë individuale apo kolektive.
2. Prokura individuale mund t'u jepet shumë personave, në ç' rast secili prokurist i ka autorizimet nga prokura.
3. Prokura kolektive mund t'u jepet dy apo më shumë personave, në ç' rast punët dhe veprimet juridike janë të vlefshme nëse ekziston pëlqimi i të gjithë prokuristëve.
4. Prokuristi nuk mund të bartë prokurën tek personat e tretë dhe e njëjta mund të revokohet në çdo kohë.

XV. FITIMI, HUMBJET DHE RREZIKU NË AFARIZËM

Përcaktimi i fitimit

Neni 75.

1. Për çdo vit afarist BPrAL Kolegji UBT e miraton planin financiar të afarizmit, me të cilin parashihen të hyrat dhe të dalat e tij.
2. Planin financiar e miraton Bordin i BPrAL Kolegji UBT me propozim të Këshillit Drejtues.

Neni 76.

1. Rezultatet e punës së BPrAL Kolegji UBT përcaktohen me llogari përkatëse, në pajtim me ligjin.
2. Bruto fitimi i BPrAL Kolegji UBT përcaktohet kur nga të hyrat e realizuara kompensohen shpenzimet afariste, shpenzimet financiare, shpenzimet jo afariste dhe të jashtëzakonshme dhe shpenzimet revalorizuese.
3. Neto fitimi (teprica) e BPrAL Kolegji UBT përcaktohet kur nga bruto fitimi kompensohen tatimet, taksat, kontributet dhe ngarkesat tjera në bazë të rezultateve të afarizmit si dhe shuma e rezervave të obligueshme në pajtueshmëri me ligjin.

XVI. PUSHIMI I PUNËS SË BPrAL KOLEGJI UBT

Neni 77.

1. BPrAL Kolegji UBT pushon të ekzistojë në rast të likuidimit apo falimentimit, nën kushte të parapara me ligj dhe me këtë Statut.
2. BPrAL Kolegji UBT mund të pushojë së ekzistuari nëse:
 - a) *i shqiptohet masa e ndalesës të kryerjes së veprimtarisë nga gjyqi apo organi tjetër kompetent;*
 - b) *themeluesi i BPrAL Kolegji UBT vendos që të ndërpretë punën dhe të pushojë;*
 - c) *inkorporohet apo bashkohet me institucione të tjera apo subjekt tjetër;*
 - d) *me vendim të Presidentit konstatohet pavlefshmëria e regjistrimit të BPrAL Kolegji UBT, falimenton;*
 - e) *nuk e kryen veprimtarinë 2 vjet pa ndërprerje, dhe në raste të tjera të parapara me ligj.*

Neni 78.

BPrAL Kolegji UBT humb cilësinë e subjektit juridik me çregjistrim nga regjistri në të cilin edhe është regjistruar.

XVII. AKTET E PËRGJITHSHME

Neni 79.

1. Akte të përgjithshme të BPrAL Kolegji UBT konsiderohen rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të cilat në mënyrë të përgjithshme rregullojnë çështjet e veprimtarisë dhe jetësimit të BPrAL Kolegji UBT.
2. Në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, Presidenti i BPrAL Kolegji UBT me vendim të vet e përcakton sistematizimin e vendeve të punës dhe kushtet për kryerjen e punëve në vende të punës për stafin e administratës së BPrAL Kolegji UBT.
3. Pos akteve të lartcekura në BPrAL Kolegji UBT mund të nxirren edhe aktet tjera.

Neni 80.

Propozimin e aktit të përgjithshëm e përpilon Presidenti, Rektori apo personi tjetër i autorizuar.

Neni 81.

1. Aktet e përgjithshme publikohen nga BPrAL Kolegji UBT në tabelën e shpalljeve apo në formë elektronike të BPrAL Kolegji UBT dhe hyjnë në fuqi tetë (8) ditë pas shpalljes së tyre.
2. Aktet e përgjithshme nuk mund të kenë ndikim (aplikim) retroaktiv.
3. Përgjithshëm, akti i përgjithshëm mund të ketë ndikim retroaktiv nëse me të nuk zvogëlohen të drejtat e fituara.
4. Nga një kopje e akteve të përgjithshme ruhet si dokumente me vlerë të përhershme në arkivin e BPrAL Kolegji UBT.

XVIII. NDRYSHIMET E STATUTIT

Neni 82.

1. Ky Statut ndryshohet dhe plotësohet në çdo rast kur konstatohet se nuk është i harmonizuar me ligj, përkatësisht kur konstatohet së mënyrat e rregullimit të çështjeve nuk janë në pajtim me interesat e shkollimit superior.
2. Ndryshimet bëhen me vendim mbi ndryshim - plotësimet e Statutit.

Neni 83.

1. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit i bën Bordi i BPrAL Kolegji UBT me vendim adekuat, sipas iniciativës së tij apo iniciativës së Presidentit.
2. Nëse Bordi nuk e miraton iniciativën për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit, është i obliguar që Këshillin drejtues ta informojë mbi shkaqet e mospranimit të iniciativës.

Neni 84.

1. Ky Statut miratohet në procedurë të përcaktuar me ligj, si dhe dispozitat e këtij Statuti mbi nxjerrjen e akteve të përgjithshme në BPrAL Kolegji UBT.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen sipas procedurës paraparë për nxjerrjen e tij.
3. Nëse me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit ndryshohen të dhënat e regjistruara në regjistrë përkatës, ndryshimet vlejnë nga data e regjistrimit të ndryshimeve në atë regjistrë.
4. Nëse me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit nuk ndryshohen të dhënat e regjistruara në regjistrë përkatës, ndryshimet dhe plotësimet hyjnë në fuqi në afat prej tetë (8) ditëve nga data e shpalljes.

XIX. PUNA PUBLIKE DHE FSHEHTËSIA AFARISTE

Neni 85.

1. Puna në BPrAL Kolegji UBT është publike.
2. Fakulteti ka për detyrë që me kohë dhe saktësisht të njoftojë publikun mbi sendërtimin e veprimtarisë së tij.
3. BPrAL Kolegji UBT njofton publikun e gjerë përmes mjeteve të informimit publik, duke dhënë komunikata të veçanta për shtyp, me publikimin e informatave të ndryshme, si dhe me publikimet e informatave në gazete dhe tabelë interne për Shpallje.

Neni 86.

1. BPrAL Kolegji UBT nuk do të njoftojë publikisht të dhënat që paraqesin fshehtësi të brendshme.
2. Fshehtësi konsiderohet të dhënat të cilat:
 - Presidenti apo edhe Rektori i determinojnë si fshehtësi afariste,
 - kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave në situata të jashtëzakonshme,
 - Shteti dhe qeveria i kanë shpallur si të besueshme.



XX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 87.

Personat të cilët kanë emërim për çdo post, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Statuti, do të vazhdojnë emërimet e tyre sipas rregullave të kontratës deri në datën kur bëhen emërimet e reja në përputhshmëri me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 88.

Çdo lloj aktiviteti i cili praktikohet në BPrAL Kolegji UBT, pavarësisht nga origjina e tij juridike ose vlefshmëria, i cili nuk është në kundërshtim me këtë Statut, do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe efektiv, derisa Themeluesi të vendosë ndryshe.

Neni 89.

Themeluesi do të jetë përgjegjës i vetëm për interpretimin e këtij Statuti.

Neni 90.

Propozimet e Këshillit Akademik, Këshillit Drejtues, apo Rektoratit në lidhje me ndryshim plotësimit e Statutit duhet miratuar nga Bordi.

Neni 91.

Studentët aktualë të BPrAL Kolegji UBT do të vazhdojnë programet e studimit në të cilat janë regjistruar, në pajtim me rregullat e këtij Statuti.

Neni 92.

Këshilli Drejtues dhe Rektorati do t'i raportojnë rregullisht Këshillit Akademik dhe Bordit të BPrAL Kolegji UBT mbi zbatimin e këtij Statuti.

Neni 93.

Ky Statut hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelë për shpallje të BPrAL Kolegji UBT.

Neni 94.

Aktet e përgjithshme të parapara me këtë Statut do të nxirren në afat prej 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Statutit.

Neni 95.

Për çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë Statut, aplikohet drejtpërdrejt ligji.

Neni 96.

Ky Statut është miratuar dhe nënshkruar në Prishtinë, Shkurt 2009, dhe i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar muajin Shtator të vitit 2015, si dhe në vitin 2018 në përputhje me kërkesat përkufizuar më Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, .

Statuti është i përpiluar në gjuhën shqipe, në kopje identike të mjaftuara për Themeluesin gjegjësisht BPrAL Kolegji UBT dhe organet tjera përkatëse.

PRISHTINË,

Shtator, 2025

PRESIDENT I BPrAL KOLEGJI UBT,

Prof. Dr. Edmond HAJRIZI, ,

